



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 520

Lënda: Epidemiologji

PROGRAMI MËSIMOR Epidemiologji								
Titullari i lëndës: / Pedagogu i lëndës:		Majlinda Zahaj <i>PhD në Shkenca Paraklinike</i>						
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
	10	Leksion	Seminar	Labs	Praktikë	Projekt klinik	110	250
		45	15	0	40	10		
Tipologjia e lëndës		Lëndë karakterizuese						
Viti akademik /Semestri kur zhvillohet lënda		Viti I, Semestri II						
Lloji i lëndës		E detyruar						
Programi i studimit		Master Shkencor në Shkenca Infermierore						
Kodi i lëndës		INF 520						
Adresa elektronike e titullarit / pedagogut të lëndës		majlinda.zahaj@univlora.edu.al						

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Përshkrimi i lëndës	Ky modul ofron njohuri të përgjithshme të kërkimit epidemiologjik, parimeve, metodave dhe aplikimeve të rezultateve të studimeve epidemiologjike. Përfaqsa epidemiologjike ndaj sëmundjes, parimet e identifikimit të faktorëve sëmundje-shkaktues, si dhe aplikimi i Epidemiologjisë në kontrollin e sëmundjeve në popullatë, janë edhe esenca e leksioneve të kësaj lënde.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">☞ Përfitimi i njohurive bazë dhe të avancuara në lidhje me parandalimin e sëmundshmërisë në popullatat njerëzore.☞ Mundësimi i identifikimit të faktorëve të rrishtit ose mbrojtës që ndikojnë në zhvillimin ose parandalimin e sëmundjeve në popullatë.☞ Përfaqsa epidemiologjike ndaj sëmundjes, parimet e identifikimit të faktorëve sëmundje-shkaktues si dhe aplikimi i epidemiologjisë në kontrollin e sëmundjes në popullatë .
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">☞ Identifikojnë dhe vlerësojnë faktorët e rrishtit që ndikojnë në zhvillimin e sëmundjeve në popullatë.☞ Vlerësojnë dhe kontrollojnë në përditshmërinë e tyre sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë në popullatë.☞ Marrin vendime klinike dhe të ndihmojnë në sigurimin e kujdesit cilësor edhe në situata shëndetësore jo shumë të njohura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

KONCEPTET THEMELORE

1. Epidemiologjia është shkencë që studion shpeshësinë, shpërndarjen dhe faktorët përcaktues të sëmundjeve në popullatat njerëzore.
2. Madhësitë e shpeshësisë së sëmundjes më të përdorshme në praktikë janë incidenca dhe prevalenca.
3. Adresimin e çështjeve të tilla si rritja apo ulja e sëmundjeve të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, në popullata të ndryshme si dhe në subjekte të ndryshme brenda të njëjtës popullatë .
4. Parimet e identifikimit të faktorëve sëmundje-shkaktues si dhe aplikimi i epidemiologjisë në kontrollin e sëmundjes në popullata

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Tema 1– Njohja me programin dhe kërkesat e lëndës. Hyrje në epidemiologji. <i>Organizimi dhe fokusi i studimit të lëndës. Njohja me literaturën bazë dhe teknikat që do trajtohen në modul.</i>		Leksion 1 orë
	Tema 2 –Historiku i epidemiologjisë <i>Njohja me inicimin dhe zhvillimin e epidemiologjisë si një disiplinë e hershme që në lashtësi dhe lidhja e saj me disiplinat e tjera.</i>	<i>fq.9-6</i>	Leksion 1 orë
	Tema 3 –Disa koncepte epidemiologjike mbi sëmundjen <i>Njohja e koncepteve epidemiologjike në studimin e sëmundjeve të transmetueshme dhe jo vetëm.</i>	<i>fq.23-40</i>	Leksion 1 orë
	Seminar 1- Historiku i epidemiologjisë dhe disa koncepte të përgjithshme epidemiologjike. Praktikë- Shoqërimet (lidhjet, varësitë) statistikore.	<i>fq.41-53</i>	<i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i>
I.	Tema 4 –Studimet e vdekshmërisë në popullatë <i>Njohja dhe mbledhja e të dhënave mbi gravitetin e sëmundjes, shpeshësinë dhe vdekshmërinë në popullatë.</i>	<i>fq.55-63</i>	Leksion 1 orë
	Tema 5 - Madhësitë njehsuese të vdekshmërisë <i>Njohja me elementët e vlerësimit të vdekshmërisë në popullatë dhe standardizimin.</i>	<i>fq.65-68</i>	Leksion 1 orë
	Tema 6 – Standardizimi i nivelit të vdekshmërisë <i>Standardizimi i drejtërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë, si realizohet secila mënyrë</i> Seminar 2 - Studimi i modeleve të vdekshmërisë Ushtrime 2 - Llogaritja e treguesve të ndryshëm të vdekshmërisë	<i>fq.68-75</i>	Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i>
I.	Tema 7 – Madhësitë e shpeshësisë së sëmundjes. Incidenca, Prevalenca <i>Njohja me nr e rasteve të reja të sëmundjes në një popullatë në një kohë të caktuar. Njohja me ngarkesën e sëmundshmërisë në popullatë në një moment kohor të caktuar.</i>	<i>fq.76-79</i>	Leksion 1 orë
	Tema 8 – Lidhja midis incidencës dhe prevalencës <i>Si ndikon rritja dhe ulja e incidencës në prevalencë dhe faktorët e tjerë</i>	<i>fq.79-86</i>	Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>që ndikojnë në të.</i> Tema 9 – Klasifikimi i studimeve epidemiologjike <i>Mënyra e klasifikimit të studimeve epidemiologjike bazuar në qëllimin e studimit, rolin e studiuesit, drejtimin kohor etj.</i></p> <p>Ushtrime 3- Standardizimi i drejtpërdrejtë i nivelit të vdekshmërisë Ushtrime 4- Raporti i standardizuar i vdekshmërisë</p>	<i>fq.129-135</i>	<i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i>
V.	<p>Tema 10 – Studimet prospektive të riskut: Studimet kohort <i>Njohja me studimin, llojet, avantazhet dhe disavantazhet e këtij studimi</i></p> <p>Tema 11 – Studimet retrospective të riskut: studimet rast-kontroll <i>Njohja me skemën e studimit, zgjedhjen e rasteve dhe kontroleve.</i></p> <p>Tema 12 - Problemet që dalin në studimet rast-kontroll <i>Aftësia për të njohur dhe konstatuar problemet në përzgjedhjen e grupeve të rasteve dhe kontroleve dhe mënyrat e shmangies së tyre.</i> Ushtrime 5/6 Ushtrime lidhur me incidencën dhe prevalencën</p>	<i>fq.87-94</i> <i>fq.95-105</i> <i>fq.105-116</i>	<i>L Leksion 1 orë</i> <i>Leksion 1 orë</i> <i>Leksion 1 orë</i> <i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i>
V.	<p>Tema 13 – Skemat e ndryshme të studimeve retrospective. Përparësitë dhe mangësitë e këtyre studimeve. <i>Studimet rast-kontroll brenda kohortit, rast-kohort, rast-kryqëzim; përparësitë dhe mangësitë e secilit.</i></p> <p>Tema 14 – Studimet transversale <i>Njohja me skemën e studimit, përparësitë dhe mangësitë e tij.</i></p> <p>Tema 15 – Tipet e studimeve pseudo-eksperimentale <i>Llojet e studimeve pseudo-eksperimentale, skema e tyre dhe ndryshimi nga eksperimentet e mirëfillta</i></p> <p>Seminar 3 – Klasifikimi i studimeve epidemiologjike Seminar 4 – Diskutim mbi studimet prospektive</p>	<i>fq.117-123</i> <i>fq.124-128</i> <i>fq.136-141</i>	<i>Leksion 1 orë</i> <i>Leksion 1 orë</i> <i>Leksion 1 orë</i> <i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i>
I.	<p>Tema 16 – Studimet eksperimentale të mirëfillta <i>Klasifikimi i studimeve eksperimentale, realizimi dhe randomizimi i subjekteve në studim..</i></p> <p>Tema 17 – Metodatat kryesore të kërkimit eksperimental në epidemiologji <i>Njohja me metodat bazë të kërkimit eksperimental dhe përjasjet e ndryshme në klasifikimin e studimeve.</i></p> <p>Tema 18 - Gabimi i tipit të parë, gabimi i tipit të dytë dhe fuqia e studimit <i>Njohja dhe diferencimi i gabimit të tipit të parë dhe të dytë si dhe vlerat për të cilat një studim është i vlefshëm</i> Seminar 5 – Diskutim mbi studimet rast-kontroll Seminar 6 – Diskutim mbi studimet transversale</p>	<i>fq.141-146</i> <i>fq.147-155</i> <i>fq. 155-158</i>	<i>Leksion 1 orë</i> <i>Leksion 1 orë</i> <i>Leksion 1 orë</i> <i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i>
I.	<p>Tema 19 – Llogaritja e madhësisë së mostrës <i>Llogaritja e madhësisë së mostrës, pavarësisht nga përjasja e studimit bazohet në dy elementë esenciale, supozime dhe zgjedhje. Spjegimi i</i></p>	<i>fq.159-164</i>	<i>Le Leksion 1 orë</i>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p>tyre</p> <p>Tema 20 – Vlerësimi i rrezikut për zhvillimin e sëmundjeve <i>Cfarë përfaqëson rreziku absolut, diferenca e rrezikut, rreziku relativ dhe interpretimi i tij.</i></p> <p>Tema 21 – Vlerësimi i rrezikut për zhvillimin e sëmundjeve <i>Cfarë kuptojmë dhe si gjenden gjasat e zhvillimit të sëmundjes dhe gjasat e ekspozimit</i> Seminar 7 - Studimet pseudo-eksperimentale Seminar 8 - Studimet eksperimentale</p>	<p><i>fq.165-167</i></p> <p><i>fq.167-170</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> <p>Praktika 3 orë</p>
I.	<p>Tema 22 – Vlerësimi i rrezikut për zhvillimin e sëmundjeve <i>Interpretimi i raportit të gjasave në studimet kohort dhe rst-kontroll</i></p> <p>Tema 23 – Madhësitë njehsuese të impaktit <i>Cfarë përfaqëson dhe si gjendet rreziku i atribueshëm në grupin e ekspozuar dhe në popullatën në total.</i></p> <p>Tema 24 – Madhësitë njehsuese të impaktit <i>Rreziku i atribueshëm është një urë lidhëse mes lidhjeve shkakësore dhe aktiviteteve ndërhyrëse në shëndetin publik .</i></p> <p>Ushtrime 7- Gabimi i tipit 1 dhe 2, llogaritja e madhësisë së mostrës Ushtrime 8- Llogaritja e RA,DR,RR</p>	<p><i>fq.170-176</i></p> <p><i>fq.177-179</i></p> <p><i>fq.179-186</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> <p>Praktika 3 orë</p>
K.	<p>Tema 25 – Vlerësimi i lidhjeve statistikore në Epidemiologji <i>Roli i shansit ose gabimi i rastit si alternativë shpjeguese e rezultateve në studimet epidemiologjike.</i></p> <p>Tema 26 – Përfillshmëria statistikore e lidhjes dhe intervali i besimit <i>Për zgjidhjen e problemeve në interpretimin e vlerave të përfuara aplikohet një madhësi më informative që pasqyron jo vetëm lidhjen statistikore por edhe madhësinë e mostrës.</i></p> <p>Tema 27 – Vlerësimi i lidhjeve statistikore në Epidemiologji <i>Gabimet sistematike (bias) të seleksionit si alternativë shpjeguese e rezultateve në studimet epidemiologjike.</i></p> <p>Ushtrime 9- Llogaritja e gjasave të sëmundjes dhe ekspozimit Ushtrime 10- Llogaritja dhe interpretimi i raportit të gjasave</p>	<p><i>fq.187-190</i></p> <p><i>fq.190-193</i></p> <p><i>fq.193-198</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Seminar 1 orë</p> <p>Praktika 3 orë</p>
K.	<p>Tema 28 – Gabimet sistematike të informacionit <i>Njohja me gabimet sistematike të lidhura me instrumentet e përdorur në mbledhjen e të dhënave</i></p> <p>Tema 29 – Gabimet sistematike të informacionit <i>Njohja me gabimet sistematike lidhur me burimet e mbledhjes së të</i></p>	<p><i>fq.198-201</i></p> <p><i>fq.201-203</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>dhënave</i></p> <p>Tema 30- Gabimet sistematike të informacionit <i>Njohja me bias-et lidhur me personelin e përfshirë në mbledhjen e të dhënave</i></p> <p>Ushtrime 11/12 Llogaritja e rrezikut të atribueshëm në grupin e ekspozuar dhe popullatën në total</p>	<i>fq.203-205</i>	<p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Seminar 1 orë</i></p> <p><i>Praktika 3 orë</i></p>
I.	<p>Tema 31 – Gabimet sistematike të informacionit <i>Njohja me bias-et lidhur me subjektet e përfshirë në studim</i></p> <p>Tema 32 – Gabimet sistematike të informacionit <i>Njohja me bias të lidhura me analizën statistikore të të dhënave</i></p> <p>Tema 33- Disa mundësi të tjera të gabimeve sistematike në Epidemiologji <i>Njohja me gabimet sistematike në interpretimin e të dhënave dhe në publikime</i></p> <p>Seminar 9 - Diskutim mbi rolin e shansit në studimet epidemiologjike</p> <p>Seminar 10- Diskutim mbi gabimet sistematike</p>	<p><i>fq.205-209</i></p> <p><i>fq.209-214</i></p> <p><i>fq.214-215</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Seminar 1 orë</i></p> <p><i>Praktika 3 orë</i></p>
I.	<p>Tema 34 – Faktorët konfondues në studimet epidemiologjike. <i>Njohja e faktorëve konfondues si mundësi shpjegimi në studimet epidemiologjike</i></p> <p>Tema 35 – Strategjitë e kontrollit të faktorëve konfondues në studimet epidemiologjike <i>Njohja me strategjitë e kontrollit të faktorëve konfondues, për të mos lejuar përfitim e konkluzioneve të gabuara mbi praninë e lidhjeve shkakësore mes ekspozimit dhe sëmundjes.</i></p> <p>Tema 36 – Faktorët modifikues, faktorët ndërmjetës <i>Njohja me faktorët modifikues dhe rëndësia e tyre praktike.</i></p> <p>Ushtrime 13 - Përfillshmëria statistikore dhe intervali i besimit</p> <p>Ushtrime 14- Gabimet sistematike</p>	<p><i>fq.215-218</i></p> <p><i>fq.218-220</i></p> <p><i>fq.220-223</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Seminar 1 orë</i></p> <p><i>Praktika 3 orë</i></p>
XIII.	<p>Tema 37- Vlerësimi i lidhjeve shkakësore në epidemiologji. <i>Njohja me kriteret madhore dhe minore të shkakësisë</i></p> <p>Tema 38- Historia e vlerësimit të një lidhjeje shkakësore <i>Shembuj të vlerësimit të lidhjes midis duhanpirjes dhe kancerit të mushkrive</i></p> <p>Tema 39- Programet depistuese <i>Programet depistuese mundësojnë identifikimin e sëmundjes që në fazën e hershme të saj ose sub-klinike dhe në këtë mënyrë bëhet një diagnostikim dhe trajtim më efektiv.</i></p> <p>Seminar 11- Diskutim mbi gabimet sistematike</p> <p>Ushtrime 15- Shembuj të faktorëve konfondues dhe/ose modifikues</p>	<p><i>fq.224-230</i></p> <p><i>fq. 231-240</i></p> <p><i>fq. 241-248</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Seminar 1 orë</i></p> <p><i>Praktika 3 orë</i></p>
V.	<p>Tema 40/41- Testet depistuese <i>Njohja me vlefshmërinë dhe besueshmërinë e testeve depistuese.</i></p>	<i>fq.249-255</i>	Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Sensitiviteti, specificiteti, vlera parashikuese pozitive dhe negative.</i> Tema 42- Gabimet sistematike madhore në programet depistuese <i>Njohja me tre gabimet sistematike kryesore në interpretimin e rezultateve të përfuara nga procedurat depistuese</i> Ushtrime 16/17- Llogaritja e Se,Sp, VP+,VP-</p>	<i>fq. 255-259</i>	<p>Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i></p>
	<p>Tema 43 – Disa konsiderata etike në epidemiologji. <i>Njohja me çështjet etike,problemet profesionale dhe detyrimet</i> Tema 44– Manaxhimi i njohurive <i>Kujdesi mbi menaxhimin e të dhënave, zotërimi dhe interpretimi i rezultateve.</i> Tema 45 – Ndjekja e zhvillimeve të reja dhe vënia e njohurive në praktikë <i>Njohja me zhvillimet e reja në fushën e epidemiologjisë dhe mundësia e vënies në praktikë të këtyre njohurive.</i> Ushtrime 18- Tipe të ndryshme ushtrimesh nga gjithë lënda Seminar 12- Diskutim mbi gjithë materialin e marrë gjatë lëndës</p>	<p><i>fq.260-264</i> <i>fq.264-270</i> <i>studime të ndryshme epidemiologjike</i></p>	<p>Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë <i>Seminar 1 orë</i> <i>Praktika 3 orë</i></p>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE						
FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshëm është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrvëshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit). Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
KONTROLLI I VAZHDESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi final	Fundi i semestrit	Gjithë lënda	90 pikë	Provimi me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Temë studimore	10 pikë	Prezantim me gojë	Raportimi i studimit shkencor
	*Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një teme studimore: studim analitik (kohort apo rast-kontroll) ose deskriptiv. Detyra do të përmbajë të gjitha elementet e temës së diplomës, me përjashtim të faktit që rastet klinike të paraqitura mund të jenë të supozuara, dhe jo të marra nga klinika.					
	Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë:					
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	5	6	7	8	9	10
--	---	---	---	---	---	----

LITERATURA	
a. Literatura bazë e detyruar	'Epidemiologjia' E.Roshi, G.Byrazeri 2009 (Fakulteti i Mjekësisë - UT) ISBN:978-99943-52-49-4
b. Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none">o 'Epidemiology' L.Gordis 2010o 'Clinical Epidemiology-the Essentials" Robert H. Fletcher, Suzanne W. Fletcher fifth edition 2014
VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.
Integriteti akademik dhe e drejta e autorit	Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.
Karakteristikat e detyrave të kursit	<i>Rregullat për paraqitjen e detyrave / projekteve të kursit:</i> <ul style="list-style-type: none">▪ Të gjitha punimet duhet të dorëzohen në kohën e caktuar. Ato duhet të tregojnë që në paraqitje një stil profesionist.▪ Duhet të jenë të shtypura. Punet me shkrim dore nuk do të pranohen dhe studenti do të vlerësohet automatikisht me 0 pikë.▪ Në punime gjuha duhet të jetë zyrtare, letrare dhe neutrale. Ndalohet rreptësisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	<p>përdorimet e zhargoneve të pa argumentuara, shprehjet që rëndojnë etikën profesionale dhe njerëzore, kërcënimet, fyret, sharjet, etiketimet, tendencat politizuese, trajtimet jashtë tematikave të kërkuara, etj.</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Punët duhet të kenë një volum me më tepër se 3 faqe (format A⁴, shkrimi Times New Roman, 12 pt) dhe në faqet e para duhet të jenë të shënuara pa gabime drejtshkrimore: <div data-bbox="683 556 1388 758" style="border: 1px solid black; padding: 5px;"><p>Emri i Studentit Titulli i punimit Kursi dhe grupi përkatës i studentit Data e dorëzimit të punimit sipas grafikut të shpallur Emri i instruktorit Numri i faqeve</p></div> <p><i>Elementët e vlerësimit të detyrës së kursit do të përfshijnë:</i></p> <p>Thelbësore:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Respektimin e struktures së punimit shkencor▪ Renditjen e argumenteve akademiko-shkencorë▪ Mënyrat specifike të trajtimit të çështjeve në raport me realitetin shqiptar <p>Ndihmëse:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Ideja e zgjedhur▪ Mënyra e organizimit të punimit▪ Logjika e përdorimit të koncepteve▪ Përputhja me objektivat e programit mësimor▪ Argumentet dhe analiza kritike
--	--